



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË**

**Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al**

Miratohet

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

PROGRAMI I STUDIMIT:

**MASTER PROFESIONAL
NË**

**"Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në "Matematikë –Fizikë" me Profil
Minor "Informatikë"".**

**ME KOHË TË PLOTË
Viti akademik 2014-2015**

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTI TË INFORMATIKË - FIZIKËS

Dr. Rafail Prodani

DEKANI

Prof. Dr. Gjergji Pendavinji

1. Emërtimi i përgjithshëm i programit të “Masterit Profesional” me kohë të plotë në.

“Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në “Matematikë –Fizikë” me Profil Minor “Informatikë””

2. Vendimet e organeve përgjegjëse për hapjen e programit të studimit

Vendimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNH).	
Vendimi i Senatit akademik të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës (UNKO).	
Urdhër ministrit të arsimit dhe shkencës. Nr. 7003/4	Nr. 507, 08/11/2010,

NIVELI I MASTERIT	SASIA E KREDITEVE
MASTER PROFESIONAL	90 kredite
Fillon më :	Tetor 2014
Përfundon më :	Mars 2016

MASTER I BRENDSHËM APO I JASHTËM PËR INSTITUCIONIN

Master i brendshëm (organizuar nga institucioni)

Master i jashtëm (organizuar nga një institucion tjetër)

STRUKTURA PROPOZUESE DHE STRUKTURAT E TJERA

Fakulteti apo një strukturë tjetër didaktike	FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE HUMANE
Struktura të tjera bashkëpunuese	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS, DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE, KORÇË
Institucione të huaja të arsimit të lartë ose Qendra të huaja kërkimore	

GJUHA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT MASTER

<input checked="" type="checkbox"/> Shqip	Shqip
<input type="checkbox"/> Në gjuhën	

KOMITETI SHKENCOR

Personeli akademik	Grada shkencore apo titulli akademik	Struktura së cilës i përket	Detyra	Spektori mësimor – Kërkimor
1. RAFAIL PRODANI	Dr.	Departamenti i Fizikës dhe Informatikës	Koordinator	Informatikë
2. GJERGJI PENDAVINJI	Prof.dr.	Dekan	Anëtar	Didaktika e shkencave humane
3. LORENC EKONOMI	Prof. Ass. Dr.	Departamenti i Matematikës	Anëtar	Statistikë

Koordinatori i programit Master : Dr. Rafail Prodani
(i zgjedhur nga Komiteti Shkencor)

3. Objektivat formuese

Qëllimi i programit të studimit

Programi i studimit ka për qëllim duke aftësuar studentet me njohurite kryesore pedagogjike, kulturore dhe metodike për të bërë mesues të mirë profesionistë në të ardhmen. Gjithashtu ata pajisen me njohuri të baze dhe avancuara në fushat kryesore të teknologjisë së informacionit, për të plotësuar nevojat e tyre për informacion, komunikim, rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve dhe si rrjedhim për të qenë mesues të mirë edhe në këto fusha nëqë e kërkon nevoja.

Objektivat e programit të studimit:

1. Të diplomuarit do të marrin njohuri bazë pedagogjike, kulturore dhe mbi metodat bazë të kërkimit si dhe do të aftësohen që këto njohuri të ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
2. Të diplomuarit do të marrin njohuritë kryesore të metodikës së, fizikës dhe matematikës si dhe do të njihen me metodat e reja të mësimdhënies dhe të mësuarit si dhe do të aftësohen për të zbatuar ato në praktikë.
3. Të diplomuarit do të fitojnë njohuritë në lidhje me ndikimin teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në mësimdhënien dhe të mësuarit. Ndihmën që mund të japë TIK gjatë procesit të mësimdhënies. Gjithashtu do të jepen edhe konceptet bazë të teorisë dhe praktikës të mësimdhënies dhe të mësuarit në internet sot.
4. Të diplomuarit do të fitojnë aftësinë për të fushat kryesore të TIK sic mund të jenë bazat e programimit, teknologjitë kryesore të internetit, rrjetat kompjuterike etj.
5. Të diplomuarit do të jenë të aftë të implementojnë teknologjitë e reja të internetit dhe IA në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të ndryshme.

4. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Departamenti Informatikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Drejtoria Arsimore Rajonale, Korce. Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Universiteti i Tiranës.
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjektë të tjera publike apo private	Subjekte private dhe publike që veprojnë në qarkun e Korçës, Shqipëri.

5. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Në tabelën 1 paraqiten kreditet e nevojshme për cdo fushë disiplinore sipas tipeve të veprimtarisë.

Tabela 1. Kreditet për cdo fushë disiplinore sipas tipit të veprimtarisë

Tipi i veprimtarisë	Fushat disiplinore	Kredite	Gjithsej
Disiplina A	Bazat kulturore të edukimit. Hyrje në shkencat e edukimit, menaxhimi i ndryshimeve individuale dhe në sistemet e edukimit	3	11
	Metodologji e mësimdhënies	4	
	Kulture gjuhe	4	
Disiplina B	Zhvillimi dhe të nxënët	4	45
	Të menduarit kritik	3	
	Metodat e mësimdhënies së Matematikës	3	
	Metodat e mësimdhënies së Fizikës	6	
	TIK në Mësimdhënie.	3	
	Programim	5	
	Programim Java	5	
	Teknologjite e Internetit	6	
	Administrim Rrjeti Kompjuterik	5	
Hyrje ne Inteligjence Artificiale	5		
Disiplina C	Metodat e kërkimit në edukim	4	7
	Seminar kërkimor (për përgatitjen e mikrotezës)	3	
Disiplina D	Konceptet baze te fizikes	2	2
	Histori i zhvillimit te mendimit matematik	2	
Disiplina E	Gjuhë angleze për qëllime specifike	3	15
	Praktike mesimore e mesimdhënies	12	
Disiplina F	Teza	10	10
			90

Për të realizuar programin e studimit janë parashikuar si veprimtari formuese *leksione, seminare, projekte dhe praktikë profesionale.*

6. Personeli akademik për realizimin e programit

Për realizimin këtij programi studimi do të angazhohet efektiviteti i departamentit të Informatikës dhe Fizikës, departamentit të Matematikës, pedagogë nga departamente të tjerë të fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, pedagogë nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Korçës, pedagogë të Universitetit të Tiranës. Në tabelën 2 paraqitet një listë e pedagogëve të parashikuar në procesin e mësimdhënies.

Tabela 2. Lista e pedagogëve të parashikuar për mësimdhënie

Personeli akademik (me kohë të plotë ose të pjesshme)	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti	Spektori mësimor - kërkimor
Gjergji Pendavinji	Prof. Dr.	F.SH.N.H. UNKO	Shkencave Sociale	Didaktika e shkencave humane
Ilia Ninka	Prof. Dr.	F.SH.N. UT	Informatikës	Informatikë
Kozeta Sevrani	Prof. Dr.	F.E. UT	M.S.I.Z.	Informatikë
Ali Jashari	Prof. Dr.	F.E. UNKO	Gjuhë Letërsisë	Gjuhë
Lorenc Ekonomi	Prof. As. Dr.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Statistikë
Aleksandra Piluri	Prof. As. Dr.	F.E. UNKO	Gjuhë Letërsisë	Gjuhë
Rafail Prodani	Dr.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Gloria Tyxhari	Dr.	F.E. UT	M.S.I.Z.	Informatike
Magdalini Vampa	Dr.	F.SH.N.H. UNKO	Filozofi-Sociologji	Filozofi
Lindita Kacani	Dr.	UNKO	Gj. A.	Gjuha Angleze
Donika Dardha	Doc.	F.E. UNKO	Gjuhë Letërsisë	Gjuhë
Blerina Çeliku	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Illir Capi	Msc.	UNKO	Informatike - Fizike	Informatike - Fizike
Dhori Beta	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Eliona Milo	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Statistikë
Marijon Pano	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë

UT – Universiteti i Tiranës.

F.SH.N – Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

F.E – Fakulteti Ekonomik.

I. F. – Informatikë dhe Fizikë.

M.S.I.Z. – Matematikës së Zbatuar, Statistikës dhe Informatikës.

UNKO – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

F.SH.N.H - Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane.

7. Plani mësimor

Në tabelën 3. 1 paraqitet plani mësimor i programit të studimit sipas disiplinave mësimore për çdo semestër.

Tabela 3.1 . Plani mësimor i programit mësimor

Disiplina mesimore apo titulli i veprimtarisë	Tipi i disipl	Ndjekja e kurseve	Kredite	Leks.	Sem.	Orë në auditor	Lloji i provimit.	Orë studimi individual
Viti I, Semestri I								
Bazat kulturore të edukimit	A	80%	3	0	0	38	Shkrim.	37
Zhvillimi dhe të nxënët	B	80%	4	0	0	50	Shkrim.	50
Të menduarit kritik	B	80%	3	0	0	38	Shkrim.	37
Metodologji e mësimdhënies	A	80%	4	0	0	50	Shkrim.	50
Kulture gjuhe	A	80%	4	0	0	50	Shkrim.	50
Metodat e kërkimit në edukim	C	80%	4	0	0	50	Shkrim.	50
Seminar kërkimor (për përgatitjen e mikrotezës)	C	80%	3	0	0	38	Shkrim.	37
Programim Java	B	80%	5	0	0	53	Shkrim.	72
			0	0	0	0		0
Gjithsej semestri parë			30			367		383
Viti I, Semestri II								
Metodat e mësimdhënies së Matematikës	B	80%	3	0	0	38	Shkrim.	37
TIK në Mësimdhënie.	B	80%	3	0	0	38	Shkrim.	37
Gjuhë angleze për qëllime specifike	E	80%	3	0	0	38	Shkrim.	37
Programim i Avancuar	B	80%	5	0	0	60	Shkrim.	65
Teknologjite e Internetit	B	80%	6	0	0	60	Shkrim.	90
Admimistrim Rrjeti Kompjuterik	B	80%	5	0	0	60	Shkrim.	65
Hyrje ne Inteligjence Artificiale	B	80%	5	0	0	53	Shkrim.	72
			0	0	0	0		0
Gjithsej semestri dytë			30			347		403
Viti II, Semestri III								
Metodat e mësimdhënies së Fizikës	B	80%	6	0	0	60	Shkrim.	90
Lende me zgjedhje ¹	D	80%	2	0	0	30	Shkrim.	20
Praktikë profesionale.	E	80%	12	200	0	0		100
Teza e diplomës.	F	80%	10	125	0	0		125
			30	325	0	90		335
Gjithsej programi i studimit		Kredite	90	Orë Lek/Se m...	1079	Tota l orë		2250

¹ Lëndë me zgjedhje:

1. Konceptet bazë të Fizikës
2. Histori e zhvillimit të mendimit matematik

Në tabelën 3. 2 paraqitet plani mësimor i programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në “Matematikë – Fizikë” me Profil Minor “Informatikë” sipas lëndëve, moduleve dhe pedagogëve.

Tipi i disipl	LENDET: a) Moduli 1 b) Moduli 2	Kredite (ECTS)	Ngarkesa ore 60'	Semestri / Pedagogu
Disiplina të shkencave të edukimit		18 ECTS	226	I
A	Bazat kulturore të edukimit: a: Hyrje në shkencat e edukimit, menaxhimi i ndryshimeve individuale dhe në sistemet e edukimit	3	38	Dr. Magdalini Vampa
B	Bazat psikologjike te edukimit: a: Zhvillimi dhe të nxënët b: Të menduarit kritik	4 3	50 38	Prof. As. Dr. A. Piluri Prof. Dr. A. Jashari
A	Bazat pedagogjike të edukimit: a: Metodologji e mësimdhënies b: Kulture gjuhe	4 4	50 50	Doc. D. Dardha Prof. Dr. A. Jashari
Kërkimi në edukim		7 ECTS	88	
C	Kërkimi në edukim: a: Metodot e kërkimit në edukim b: Seminar kërkimor (për përgatitjen e mikrotezës)	4 3	50 38	Prof. Dr. Gjergji Pendavinji Dr. Magdalini Vampa
Mesimdhënia dhe te nxenit		13ECTS	143	II dhe III
B	Mesimdhënia dhe te nxenit: a: Metodot e mësimdhënies së Matematikës b: Metodot e mësimdhënies së Fizikës c: TIK në Mësimdhënie.	4 6 3	45 60 38	II Msc. E. Milo III Msc. S. Marko II Dr. R. Prodani
Shprehi gjuhësore dhe komunikimi		3 ECTS	38	II
E	Shprehi gjuhësore dhe komunikimi: a: Gjuhë angleze për qëllime specifike	3	38	Dr. Lindita Kaçani
Formim akademik për një disiplinë shtesë (Informatike)		25 ECTS	279	I, II dhe III
B	Programim i avancuar: a: Programim i Avancuar b: Programim Java	10 ECTS 5 5	60 53	II Msc. Ilir Capi I Msc. B. Celiku
B	Web design dhe rrjeta kompjuterike: a: Teknologjitë e Internetit b: Admimistrim Rrjeti Kompjuterik	15 ECTS 5 5	60 60	II Dr. R. Prodani II

	c: Hyrje në Inteligjencë Artificiale	5	53	Prof. dr. Kozeta Sevrani M. Pano II Prof. Dr. Ilia Ninka Msc. B. Celiku
Lëndë me zgjedhje:		2 ECTS	30	III
D	a) Konceptet bazë të fizikës.	2	30	Dr. Thoma Lice
	b) Histori i zhvillimit të mendimit matematik.	2	30	Prof. As. Dr. L. Ekonomi
E	Praktikë mësimore e mësimdhënies	12 ECTS	200	III
F	Tezë e diplomës	10 ECTS	125	III
TOTAL		90 ECTS	1129	

Tabela 3.1 . Plani mësimor i programit mësimor

Programet e studimit të ciklit të parë që mundësojnë pranimin në programin e studimit të ciklit të dytë

a) *pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:*

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Diplome Bachelor “Matematikë Informatikë”, F.SH.N.H, UNKO Diplome Bachelor “Matematikë Fizikë”, F.SH.N.H, UNKO
Nga institucione të tjera të arsimit të lartë	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Degë të ngjashme të universiteteve brenda vendit dhe të huaja (Profili: Matematikë - Fizikë)

b) *Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:*

Për studentët që janë në zotërim të një diplome:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë	Kredite për t’u plotësuar
--	----------------------------------

Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve per t'u plotësuar		Do të shqyrtohen sipas rasteve në departament, minimum 24 kredite.
Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar		Do të shqyrtohen sipas rasteve në departament, minimum 24 kredite.

8 Infrastruktura në dispozicion të programit

a. Auditorë

F.SH.N.H ka në dispozicion 1 auditor me kapacitet rreth 140 vende, 2 auditorë me kapacitet 80 vende 10 klasa për zhvillimin e orëve të seminareve me kapacitet 20- 40 vënde, dy laboratorë kompjuterat me 30 kompjutera secili, , internet broadband 24 orë në gjitha ambjentet e fakultetit. Universiteti i “Fan S. Noli” i Korçës ka marrë në pronësi edhe shtëpinë e oficerave, Korcë dhe rreth 10 klasa me kapacitet 30 vënde do të vihen në dispozicion të programeve master.

b. Laboratorë

F.SH.N.H ka 2 laboratorë informatike me rreth 30 vende secili.

c. Biblioteka

F.SH.N.H ka 1 bibliotekë në dispozicion të të gjithë studentëve të fakultetit, e organizuar sipas një sistemi bashkëkohor kërkimi dhe studimi. Kjo bibliotekë garanton mbështetjen e programit të studimit me një informacion të përditësuar të nivelit të lartë.

9. Kriteret specifike të pranimit të studentëve në program

Numri i studentëve që do të pranohen në program	30
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	10

Kritere të tjera pranimi

Në rast kur numri i kërkesave kalon 30, do të merret parasysh dokumentacioni i secilit student:

1.	Tipi i Diplomës së Ciklit të parë të studimeve
2.	Mesatarja (mesatarja 5 = 0 pikë, 5.1 = 1 pikë, 10 = 50 pikë)
3.	Njohja në nivel të lartë e gjuhës angleze

Shënim: Shkronjat a, b, c, d, e, h, i, j të pikës 14 të Udhëzimit nr. 15, dt. 04.04.2008 janë përfshirë në informacionin e mësipërm.

Pikat e tjera të Udhëzimit

f) Mundësitë e transferimit të studentëve ndërmjet programeve të studimit të ciklit të dytë

Studentët, të cilët ndjekin Programin e studimit të “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në “Matematikë –Fizikë” me Profil Minor “Informatikë”” mund të transferohen në një program tjetër të Ciklit II në Universitetin e Korçës ose në programe të tjera studimi të ngjashme në Universitete të tjera. Ndërkaq studentët të cilët ndjekin një Program tjetër studimi të Ciklit II të ngjashme me Programin “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në “Matematikë –Fizikë” me Profil Minor “Informatikë”” mund të transferohen në programin e studimit të Ciklit II në “Matematikë-Fizikë me profil minor Informatikë” të Fakultetit të SH.N.H. Në lidhje me transferimin e dytë të përmendur, do të analizohet çdo rast në veçanti.

g) Modalitetet e përgatitjes, paraqitjes dhe vlerësimit të tezës së diplomës

Mbrojtja e Temës së Diplomës Master bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim. Ky punim presupozohet të përbëjë rezultatin e një kërkimi me origjinalitet shkencor, si nga pikëpamja e përzgjedhjes së argumentit ashtu edhe për nga metodologjia e kërkimit. Punimi i diplomës duhet të përmbajë rreth 30-60 faqe në format A4.

Struktura e punimit:

Punimi duhet të shkruhet me shkrim Times New Roman, Font 12, Hapësira midis rreshtave 1,15.

1. Hyrje: përse kjo temë?
2. Ç’ështëjet themelore në fushën e brendisë.
4. Argumentet dhe analiza e të dhënave.
5. Përfundime, propozime, bibliografi.

Tipologjitë e temave:

Temat e hartuara nga studentët diplomantë do të jenë në fushat e mëposhtme:

- *Didaktika e matematikës, fizikës dhe informatikës.*
- *Didaktika e Algjibrës dhe Analizës matematike.*
- *Didaktika e probabilitetit dhe statistikës.*
- *Metodat e kërkimit.*
- *Metodologjia e mesimdhenies.*
- *Zhvillimi i aplikimeve në biznes (business application development)*
- *Inteligjenca artificiale (AI)*
- *Siguria në Internet (Internet security)*
- *Rrjetat dhe komunikimi (communication and networking)*
- *Aplikime të Database management systems (DBMS applications)*
- *Online learning technologies and practice.*
- *Assessment of penetration, use and impact of ICT in society.*

Tema e diplomës së Ciklit II zhvillohet nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Gjithashtu, tema e diplomes ka dhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin në fillim të semestrit të tretë, të cilët firmosin një formular. Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohen përfundimisht pranë Sekretarisë së Departamentit.

Për t'u pranuar në provimin e mbrojtjes së temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit dhe praktikat, pra të ketë marrë 80 kredite të Ciklit II. Punimi dorëzohet një muaj përpara datës së mbrojtjes në tre kopje. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate dhe nuk kanë marrë 80 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e dimrit. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar, gjithashtu, punimin një muaj përpara datës së mbrojtjes, studentëve u buron e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin pasardhës.

Komisioni dhe vlerësimi

Komisioni përbëhet nga 3-5 pedagogë, prej të cilëve njëri është oponent dhe të tjerët duhet të jenë të fushave përkatëse. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Departamentit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere: përmbajtja e punimit, mënyra e paraqitjes me gojë dhe mesatarja e dy viteve të studimeve.

k) Propozimi për tarifën e shkollimit, të argumentuar me koston

Programi i Studimit "MASTER PROFESIONAL" financohet me tarifën e shkollimit të aplikantëve në këtë Program, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.

RREGULLORE MËSIMORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në "Matematikë –Fizikë" me Profil Minor "Informatikë"

Hartimi i kësaj rregulloreje është bazuar në ligjin nr. 9741 dt.21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", në udhëzimin nr. 14, dt. 03.04.2008 "Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në IPAL, si edhe në udhëzimin nr.15, dt. 04.04.2008 " Për organizimin e studimeve në IPAL".

1. PARATHËNIE

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të mbështesë organizimin e programeve të studimit duke orientuar drejt studentët në mbarëvajtjen e studimeve. Rregullorja specifikon aspektet organizative të programeve të studimit të ciklit të dytë në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane.

Departamenti "Informatikës dhe Fizikës" dhe ai i "Matematikës" ofron për studentët një program studimi Master Profesional me kohë të plotë.

2. PROGRAMET E STUDIMIT DHE TITUJT PËRKATËS

Program studimi i Ciklit II me lëshimin e diplomës universitare :

**"Master Profesional" në
Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në "Matematikë –Fizikë" me Profil Minor
"Informatikë"**

3. NUMRI MAKSIMAL I KREDITEVE QË NJIHEN NË KËTË PROGRAM STUDIMI PËR NJOHURI TË PËRFTUARA MË PARË NGA STUDENTËT

Studentët që zotërojnë një DNP në " Matematikë Fizikë" dhe "Matematikë Informatikë" të lëshuar nga F.SH.N.H. ose diplomë Bachelor në këtë degë, futen pa plotësim të njohurive formuese në Programin e Ciklit II në **"Matematikë-Fizikë me profil minor Informatikë"**.

Për të gjitha diplomat e ciklit të parë, të lëshuara nga Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë, bëhet vlerësimi rast pas rasti nga Komisioni vlerësues. Kërkesat për vlerësim duhet të dorëzohen brenda datës 20 të muajit shtator në Sekretarinë mësimore. Vlerësimi i dokumentacionit bëhet brenda datës 27 shtator dhe njoftimi një ditë më pas.

Shlyerja e debiteve formuese nga cikli bachelor bëhet gjatë vitit të parë të Ciklit të dytë, në sesione që do përcaktojnë dekanati.

4. KRITERET E PRANIMIT NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMIT

Që studenti të regjistrohet në programin Master Profesional në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm dhe të Ulët në "Matematikë –Fizikë" me Profil Minor "Informatikë" duhet të zotërojë një Diplome Bachelor në " Matematikë Fizikë " dhe "Matematikë Informatikë" (pa plotësim të njohurive formuese).

Për studentët që mund të vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë shqiptare apo të huaja, të cilët zotërojnë një diplomë analoge me atë të FSHNH, të UNKO, shqyrtohet dokumentacioni rast pas rasti (shih pika 3 e rregullores).

Në rast se numri i kërkesave të paraqitura kalon numrin e parashikuar nga Fakulteti, do të zbatohen kritere të tjera specifike:

- a. Tipi i diplomës bachelor
- b. Njohja në nivel të lartë e gjuhës angleze, diploma perkatese.
- c. Mesatarja (mesatarja 5 = 0 pikë, 5.1 = 1 pikë...10 = 50 pikë)

Pranimi i studentëve në ciklin e dytë bëhet në muajin shtator. Kërkesat për pranim paraqiten pranë Sekretarisë mësimore brenda datës 20 shtator. Brenda 1 jave nga afati i përfundimit të kërkesave, Komisioni vlerësues i fakultetit shqyrton kërkesat dhe jep vlerësimet përkatëse. Në rastin e paraqitjes të më shumë kërkesave sesa numri i parashikuar hyn në zbatim pika 4 (a, b, c).

5. KUSHTET DHE PROCEDURAT E MODALITETET PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE

Studentët mund të transferohen nga një universitet në tjetrin brenda të njëjtit program studimi vetëm pas vitit të parë. Komisioni vlerësues, që ngrihet në fakultet, vlerëson rast pas rasti dokumentacionin dhe formimin e studentit, për të përcaktuar nëse i duhet të shlyejë ndonjë lëndë, që ai nuk e ka zhvilluar në vitin e parë. Kërkesat për transferim duhet të dorëzohen brenda datës 10 të muajit shtator në sekretarinë mësimore. Vlerësimi i dokumentacionit bëhet brenda datës 15 shtator dhe njoftimi një ditë më pas.

5. FORMAT E STUDIMIT, TË PROVIMEVE DHE VERIFIKIMEVE TË TJERA TË DIJEVE TË FITUARA NGA STUDENTËT

Forma e studimit është me kohë të plotë. Format e provimeve janë provime me shkrim, kompjuter dhe ose me gojë, sipas programit të çdo moduli. Gjithashtu, për të gjitha modulet parashikohet verifikim i vazhdueshëm i njohurive si dhe vlerësim i njohurive përgjatë semestrit. Vlerësimi i vazhduar zë 30% të vlerësimit përfundimtar të studentit.

Vlerësimi përfundimtar në bazë të totalit të pikëve të provimit dhe vlerësimin të vazhduar do jetë:

deri në 39 pikë	Nota 4
40-50	Nota 5 (minimumi i pikeve 40)
51-60	Nota 6
61-70	Nota 7
71-80	Nota 8
81-90	Nota 9
Mbi 91	Nota 10 (maksimumi i pikeve 100)

6. MBROJTJA E TEZËS SË DIPLOMËS

Mbrojtja e Temës së Diplomës Master Profesional bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim. Ky punim presupozohet të përbëjë rezultatin e një kërkimi me origjinalitet shkencor, si nga pikëpamja e përzgjedhjes së argumentit ashtu edhe për nga metodologjia e kërkimit. Punimi i diplomës duhet të përmbajë rreth 30-60 faqe në format A4 (me rreth 2000 karaktere në faqe).

Tipologjitë e temave:

Temat e hartuara nga studentet diplomante do të jenë në fushat e mëposhtme të sistemeve të informacionit:

- *Didaktika e matematikës.*
- *Didaktika e fizikës.*
- *Didaktika e informatikës.*
- *Didaktika e Algjebërës dhe Analizës matematike.*
- *Didaktika e probabilitetit dhe statistikës.*
- *Metodat e kërkimit.*
- *Metodologjia e mesimdhenies.*
- *Zhvillimi i aplikimeve në biznes (business application development)*
- *Inteligjenca artificiale (AI)*
- *Siguria në Internet (Internet security)*
- *Rrjetat dhe komunikimi (communication and networking)*
- *Aplikime të Database management systems (DBMS applications)*
- *Online learning technologies and practice.*
- *Assessment of penetration, use and impact of ICT in society.*

Tema e diplomës së Masterit Profesional zhvillohet nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Gjithashtu, tema e diplomes ka dhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin në fillim të semestrit të tretë, të cilët firmosin një formular. Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit

të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohen përfundimisht pranë Sekretarisë së Departamentit.

Për t'u pranuar në provimin e mbrojtjes së temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit (praktikat), pra të ketë marrë 80 kredite. Punimi dorëzohet një muaj përpara datës së mbrojtjes në tre kopje. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate dhe nuk kanë marrë 80 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e dimrit. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar, gjithashtu, punimin një muaj përpara datës së mbrojtjes, studentëve u buron e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin pasardhës.

Komisioni dhe vlerësimi

Komisioni përbëhet nga 3-5 pedagogë, prej të cilëve njëri është oponent dhe të tjerët duhet të jenë të fushave përkatëse. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Departamentit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere: përmbajtja e punimit, mënyra e paraqitjes me gojë dhe mesatarja e dy viteve të studimeve të programit Master Profesional.

7. DETYRIMET QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

Studentët janë të detyruar të frekuentojnë 80% të leksioneve dhe të seminareve. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, studenti shpallet përsëritës për atë lëndë.

8. DETYRIME PENGUESE

Programi i studimit i Masterit Profesional ka në total 90 kredite. Studenti, i cili nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit përpara mbrojtjes së Tezës së diplomës, nuk mund ta bëjë mbrojtjen. Vetëm pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet që parashikon programi, ai mund të bëjë mbrojtjen e tezës.

9. KALENDARI I PROGRAMIT MËSIMOR DHE I PROVIMEVE

Programi i studimeve "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në "Matematikë –Fizikë" me Profil Minor "Informatikë"" do të zhvillohet në 1.5 vite akademik, i ndarë në 3 semestra dhe përfundon me realizimin e 90 krediteve.

Viti akademik është i organizuar në javë mësimore, javë provimesh dhe javë praktike profesionale në shkolla dhe përgatitje për mbrojtjen e temës së Diplomës.

Shlyerja e provimeve bëhet në 3 sesione: sesioni i dimrit (muajt janar-shkurt), sesioni i verës (muajt qershor-korrik), sesioni i vjeshtës (muaji shtator). Për mbrojtjen e tezës së diplomës janë 2 sesione: sesioni i dimrit dhe sesioni i vjeshtës.

Datat përcaktohen në çdo fillim të vitit akademik me vendim dekanati.

Programin e studimit "Master Profesional" në "Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në "Matematikë –Fizikë" me Profil Minor "Informatikë"" e ofron Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane i Universitetit "Fan S.Noli".

10. PLANET MËSIMORE ME MODULET DHE KREDITET PËRKATËSE

Plani mësimor është paraqitur në pikën 7 të këtij dokumentacioni

11. OBJEKTIVAT FORMUESE SPECIFIKE PËR VEPRIMTARITË FORMUESE

Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë), tipi A

Këto disiplina synojnë pajisjen e studentëve me dijet bazë kulturore të edukimit si dhe bazat pedagogjike të edukimit.

Disiplina të formimit karakterizues, tipi B

Këto disiplina të formimit profesional synojnë në pajisjen e studentit me kompetencat e duhura për t'iu përgjigjur kërkesave aktuale të të mësuarit dhe mësimdhënies. Gjithashtu ato e aftësojnë studentin kryesisht në aftësitë programuese, administrimin e rrjeteve kompjuterike, Inteligjencës artificiale.

Disiplina të ngjashme ose integruese, tipi C

Disiplinat e ngjashme synojnë në një formim plotësues të studentit me dije nga fusha të ngjashme apo integruese edukimi.

Disiplina formuese me zgjedhje nga studentët, tipi D

Disiplinat formuese të zgjedhura nga studentët.

Disiplina formuese të fushave ndihmëse, praktikave profesionale etj, tipi E

Këto disiplina synojnë një formim më të veçantë të studentëve për disa fusha ndihmëse, si anglishtja dhe komunikimi. Ato e ushtrojnë atë në përballjen me individë apo grupe të natyrave të ndryshme dhe të veçanta.

- Praktika synon aftësimin e studentit me njohuri praktike për konceptimin, dizajnin, realizimin e një ore mesimore në shkollë.
- Një bashkëpunim i vlefshëm për kryerjen e praktikave në shkollat e mesme të rajonit, është ai me **Drejtorinë Rajonale Arsimore, Korçë**, në bazë të marrëveshjes që kemi në si fakultet i **Shkencave Natyrore dhe Humane**. Gjithashtu do bashkëpunojmë edhe me **Drejtoritë e tjera rajonale**.

Disiplina formuese për tezën e diplomës, tipi F

12. VEPRIMTARITË E ORIENTIMIT DHE TË KUJDESTARISË

Këto veprimtari synojnë këshillimin e studentëve, duke i ftuar ata që të marrin informacion të detajuar në fakultet dhe duke organizuar takime të drejtpërdrejta me to në mjediset e fakultetit.

Kujdestaria për studentët organizohet në rang fakulteti nga një grup pedagogësh, të cilët orientojnë vazhdimisht studentët përpara se të zgjedhin një program të caktuar studimi dhe përgjatë shkollimit.

13. KONTROLLE PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN PERIODIK TË KREDITEVE TË FITUARA NGA STUDENTËT QË KANË NDËRPRERË PËRKOHËSISHT STUDIMET PËR TË GARANTUAR MOSVJETËRIMIN E DIJEVE

Studentët, të cilët kanë ndërprerë studimet dhe janë larguar për një kohë të pacaktuar, mund të paraqesin një kërkesë për ripranim përpara përfundimit të vitit akademik në vijim. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni vlerësues, i cili përditëson njohuritë e kandidatëve me ndryshimet që mund të ketë pësuar programi i studimit.

Edhe studentët që i kanë zgjatur studimet për më shumë se 1.5 vjet përtej kohës normale të fitimit të diplomës, para dhënies së tezës së diplomës, Komisioni vlerësues verifikon dhe vlerëson kreditet e fituara.